



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .06.2025

MBLEDHJA Nr. 23,
Datë 03.06.2025, ora 10:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Martë, datë 03.06.2025, ora 10:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 23 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi kërkesën e shoqërisë “Energovia.Albania” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “TAMARA HYDRO ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit dhe të tregtimit të energjisë elektrike.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “ZENINA” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për transferimin e aseteve të paluajtshme të saj, si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.
4. Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a. për miratimin e rregullores së alokimit të kapaciteteve afatgjatë.
5. Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a. për miratimin e “Rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, datë 23 nëntor 2017, për miratimin e një udhëzuesi për balancimin e energjisë elektrike”.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “Balkan Green energy” sh.p.k. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqëritë OSSH sh.a. dhe FTL sh.a.
7. Mbi implementimin e intervalit kohor 15 minuta në operimin e proceseve në tregun e balancimit.
8. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE nr. 283, datë 18.12.2024.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI